



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

NR. 10, DATË 28 / 02, 2022



**“MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË
GJIROKASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË DO TË
PËRDORET NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE BUJQËSOR”.**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 25, nenit 55 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, dt. 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, të Ligjit nr. 8744, dt. 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Vendimit nr. 500, dt. 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësinë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 15, dt. 30.06.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyren e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 28/02/2022

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë të pasurisë me nr. Kadastral 28, ndodhur në Z.K 2989, fshati Plesat, e llojit “Tokë Bujqësore” me sipërfaqe 46800 m², e cila është tokë e pa trajtuar me Ligjin 7501, sipas formularit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të pikës 6, nenit 55 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni I Prefektit Gjirokastrë.

SEKRETAR

Etleva Yzo



KRYETARI I KËSHILLIT

Lavdi Hasani

Hy 22